



NGJALLJA

Nr. 1 (192) Viti XVIII i botimit

JANAR 2009

Çmimi 20 lekë

Mesazhi i Krishtlindjeve

ÇUDI!

† Anastasi

Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë

Klerit dhe besimtarëve shpresëtarë Orthodhoksë,
Bij të shtrenjtë më Zotin,

“Fjala, i bashkëqenshëm me Atin, ngjizet prej gjakrash virgjërorë,..., lind në shpellë, çudi!” (Lavdërimi i Himneve të 21 dhjetorit).

Të gjitha sa lidhen me festën e Krishtlindjes habisin. “Fjala”, i paafueshmi dhe i pakonceptueshmi, “që ka të qenët një me Atin”, “bir njeriu” bëhet, që ta çojë përfundimisht njeriun në lartësi të jashtëzakonshme: në hyjnizim. Biri i Perëndisë, duke marrë natyrën njerëzore, “që me anë të kungimit të Hyjnisë të bashkëhyjnizohet njerëzoria” (Shën Grigori i Nisës), i dha vlerë të habitshme çdo personi njerëzor në mbarë dhenë. E lartësoi njeriun, në mënyrë të pakrahasueshme, më tepër nga sa është përpjekur çfarëdolloj teorie humaniste dhe teze ateiste.

Kjo ngjarje kozmohistorike zhvillohet në një mënyrë të çuditshme: Nëna Virgjëreshë, pas Lindjes, “e mbështolli atë me shpërgënj dhe e vendosi në grazhd, sepse nuk kishte vend për ata atje ku kishin rënë” (Lluk. 2:7). Ai që vjen për të udhëhequr gjininë njerëzore drejt shpëtimit “lindet në shpellë”, mohon çdo lloj forme të botës së jashtme, përbuz luksin, jeton nga çasti më i parë jetën e njerëzve të thjeshtë, të të përulurve dhe të varfërve, pra të shumicës dërrmuese të popullsisë së tokës.

Por në të njëjtën kohë, Ungjillorët zbulojnë një tjetër prani të habitshme: Rreshta engjëjsh që këndojnë “Lavdi Perëndisë në më të lartat dhe mbi dhenë paqe, e mbi njerëzit mirëdashje”. Më tej habit



adhurimi i të urtëve nga Lindja dhe mania paranojake e Herodit, që kërkon të shfarosë Foshnjën Hyjnore, si kundërshtarin e tij të ardhshëm. Himnologjia e Kishës sonë na e tregon këtë ngjarje mahnitëse: “Fjala, që ka të qenët një me Atin, pasi u zu prej gjakrash të dëlirë virgjërorë (pasi u ngjiz në mitrën e Virgjëreshës),... lind përsëri në shpellë: çudi!” Fjala e përrjetshme e Perëndisë, vjen në kohën e kësaj bote në një mënyrë të panjohur më parë, në heshtje dhe thjeshtë.

(vijon në faqen 7)

Tiranë - Pritje me rastin e Krishtlindjeve në Kryepiskopatën e Shenjtë



Atmosfera festive e Krishtlindjeve u ndje edhe në mjediset e Kryepiskopatës së Shenjtë, ku u pritën vizitat e urimit të përfaqësuesve të komuniteteve të tjera fetare, personaliteteve të larta shtetërore dhe të jetës shoqërore të vendit, trupit diplomatik, besimtarëve etj.

Për të urrear besimtarët orthodhoksë erdhi në Kryepiskopatën e Shenjtë Presidenti i Republikës z. Bamir Topi, me bashkëshorten. Ai pati një shkëmbim të ngrohtë urimesh me Kryepiskopin Anastas.

Duke u larguar nga Kryepiskopata e Shenjtë, Presidenti do të de-

klaronte para mediave se: “Natyrisht që sot është një ditë shumë e veçantë, një ditë e gëzuar. Dëshiroj të jap një mesazh urimi për të gjithë besimtarët e krishterë dhe ky mesazh është për të gjithë popullin shqiptar. Besoj se nuk e teprojmë të japim të njëjtin mesazh se Festa e Krishtlindjeve është festë për të gjithë shqiptarët, sikurse të gjithë ne festojmë Bajramin. Kjo është shenjë e harmonisë fetare tradicionale, por kjo është një ditë shumë e rëndësishme për të dhënë më shumë mesazhe paqeje, për më shumë
(vijon në faqen 6)

22 dhjetor, në Muzeun Historik Kombëtar

Koncert me Muzikë Bizantine me rastin e Krishtlindjeve

Pasuria e thesarit shpirtëror dhe artistik të Muzikës Bizantine u për-coll gjatë periudhës para Krishtlindjes nëpërmjet koncertit “Ç’të të blatojmë, o Krisht, që u duke mbi dhé!”, nga Kori Kishtar Bizantin “Shën Joan Kukuzeli”. Shfaqja u dha me nivel të lartë artistik dhe u mirëprit dhe nga besimtarët në Kavajë, Vlorë, Fier e Berat.

Më 22 dhjetor, kori dha koncert edhe në një nga sallat e Muzeut Historik Kombëtar, në Tiranë, ku mes pjesëmarrësve, besimtarë, klerikë dhe artdashës, ishin të pranishëm edhe Kryepiskopi Anastas, Episkopi i Apollonisë, Nikolla dhe Episkopi i Krujës, Andoni.

“Psalim për Krishtlindjen, sepse kur ndodhi ajo psalën edhe engjëjt, diçka unike midis festave të mëdha! Psalim himnin e gëzueshëm për botën e tërë - “Lavdi Perëndisë që është në më të lartat dhe mbi

dhenë paqe dhe mbi njerëzit mirëdashje.” - u tha gjatë programit nga prezantuesi i korit.

Kori Kishtar Bizantin “Shën Joan Kukuzeli”, i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë u formua në vitin 1995, në Tiranë. Pjesëmarrës në të janë kryesisht të rinj orthodhoksë, të cilët kanë

mbaruar Akademinë Teologjike “Ngjallja e Krishtit”, në Shën Vlash, Durrës, apo kurset e herëpashërshme të muzikës bizantine në Tiranë. Katër nga ata kanë mbaruar studime për muzikë bizantine jashtë vendit.

Drejtues dhe themelues i korit është Atë Justini, murg-prift nga Mali i Shenjtë, i cili shërben në

vendin tonë që nga viti 1992.

Ky kor, që sot përbëhet nga 20 elementë, ka realizuar edhe regjistrime të ndryshme dhe ka nxjerrë deri tani 6 kaseta/CD me himne kishtare në shqip. Gjithashtu, ka dhënë edhe shumë koncerte në qytete të ndryshme të vendit dhe jashtë Shqipërisë.



Kori
Kishtar
Bizantin
“Shën Joan
Kukuzeli”
gjatë
koncertit.

Festivali i 11-të i Rinisë Orthodhokse

Më 26 dhjetor 2008, salla kryesore e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, e mbushur nga qindra pjesëmarrës, do të shpërthente nga zërat rinorë dhe urimet e zjarra për Krishtlindje të bekuara dhe një vit të begatë. Këngë, valle, recitime ... atmosferë emocionuese dhe me ngjyra të vërteta festive.

Në skenë do të ngjiteshin njëri pas tjetrit grupet rinore bashkë me fëmijët e shkollave 9-vjeçare të Kishës sonë. Ata përcollën këngë të

krishtera dhe popullore, valle tradicionale, recitime dhe pjesë drame. Gjithçka e shoqëruar me dritën që rrezatonte nga fytyrat e tyre të qeshura. Midis tyre ishte edhe ideatori dhe mbështetësi kryesor i këtij festivali, Kryepiskopi Anastas, i shoqëruar nga Mitropoliti i Beratit, Hirësi Ignati, Episkopi i Apollonisë, Hirësi Nikolla, Episkopi i Krujës, Hirësi Andoni, klerikë dhe besimtarë.

Për më shumë se tri orë u krijua një atmosferë bashkëpunimi dhe

vëllazërimi, e shprehur në harmonizimin e prezantimit të vlerave të krishtera dhe atyre popullore. Falënderime dhe mirënjohje për të gjithë ata që merrnin pjesë, e sidomos për ata që kanë kontribuar në ndërtimin dhe përparimin e këtij festivali. 15 grupe rinore (pas përzgjedhjes në festivalet e dioqezave të tyre organizuar gjatë muajit dhjetor), sollën vlerat karakteristike të zonave të tyre. Përveç grupeve konkurruese festivalin e përshëndetën me këngë dhe

valle festive edhe disa grupe të tjera rinore dhe fëmijësh orthodhoksë.

Drama “Falja, forma finale e dashurisë”, paraqitur për publikun nga të rinj të grupit rinor të Tiranës, përshëndetja e Gavril dhe Maria Priftit, me këngët “Dashuria e Perëndisë” dhe “Kambanat bien përsëri” dhe pjesët e tjera përshëndetëse krijuan një atmosferë të veçantë.

Pas prezantimit të grupeve dhe pritjes për vendimin e jurisë për fituesin e këtij festivali, Kryepiskopi Anastas përshëndeti pjesëmarrësit. Ai përgëzoi dhe vlerësoi këtë aktivitet me nivel të lartë.

Në fund, juria e festivalit ndau çmimet për grupet fituese. Sivjet, çmimin inkurajues e mori grupi i Këlcyrës, e më pas u ndanë dy çmime për vendin e tretë, përkatësisht për grupet rinore të Beratit dhe të Korçës, vendin e dytë e meritoi grupi rinor i Kavajës, ndërsa vendin e parë e mori grupi rinor i Tiranës, me paraqitje të shkëlqyer dhe shumë duartrokitje.



Nga kremtimet e Krishtlindjeve në Mitropolitë e Shenjta

Berat

Qindra besimtarë ndoqën Liturgjinë e Krishtlindjes në kishën e Shën Spiridhonit, të kryer nga Mitropoliti i Beratit, Vlorës, Kaninës dhe gjithë Myzeqesë, Imzot Ignati, i ndihmuar nga klerikë të tjerë të kësaj mitropolie.

Në mesazhin drejtuar besimtarëve Hirësi Ignati tha ndër të tjera:

“Le të jetë i nxehtë falënderimi ynë ndaj paqebërësit, Zotit tonë Jisu Krisht, që për shpëtimin tonë u bë njeri; dhe le të jetë një dëshirë dhe përpjekje e jona të jetojmë shpëtimin tonë dhe të bëhemi me të vërtetë “bij të Perëndisë”. Gëzimi, që vjen si rrjedhim tek ata që shijojnë çlirimin nëpërmjet pendimit dhe rrëfimit hyjnor, nuk përbën një dëshirë të paarritshme, por është për secilin një realitet i prekshëm, një përjetim personal. Me të drejtë admirojmë dhe habitemi për këtë përlësi të skajshme të Zotit. A kemi nevojë për diçka tjetër? Përlësia jonë, gjendja e paqme dhe thjeshtësia është rruga që duhet të përshkojmë për te Zoti. Vetëm kështu do të ndiejmë tërë madhësinë dhe bukurinë e Krishtlindjeve. U bëftë!”



Korçë

Në datën 20 dhjetor u zhvillua në sallën poshtë katedrales “Ngjallja e Krishtit” aktiviteti i përvitshëm festiv në prag të Krishtlindjes. Në të morën pjesë grupe artistike nga Mitropolia. Mbas prezantimit të programit të pranishmit i përshëndeti edhe Hirësi Joani.

Në përfundim, u prezantua ekspozita e piktorëve të rinj, të cilët vinin nga shkolla e mesme artistike e qytetit.

Më 23 dhjetor, në orët e pasdites një tjetër festim tradicional, kolendrat. Grupe fëmijësh, të rinjsh, por edhe më të moshuar ishin derdhur rrugëve të qytetit duke shpallur lajmin gazmor se në botë lindi Shpëtimtari. Kjo traditë, e cila ruhet fort në qytetin e Korçës, sa vjen dhe merr përmasa më të gjera. Gëzimi që buron nga Krishtlindja prek gjithmonë e më shumë identitetin e çdo cepi të qytetit. Grazhde të zbukuruar kalojnë rrugëve dhe këngët gazmore të kolendrave zgjojnë brenda njerëzve ndjenjën e shpresës.

Apogjeu i festës së Krishtlindjes ishin kambanat e datës 25 Dhjetor, kur festimi arriti kulmin e tij me meshën e Krishtlindjes, në të gjitha kishat e qytetit. Qindra e mijëra besimtarë u mblodhën në këtë ditë pranë kishave të enorive të tyre. Ndërsa në katedralen “Ngjallja e Krishtit” liturgjia u celebrua nga Mitropoliti Korçës, Joani.

Në përshëndetjen e tij Hirësia e Tij Joani tha ndër të tjera: *“Nga ajo dritë e Betlehemit deri më sot nuk është zbehur asgjë, ai gëzim i barinjve, ai gëzim i magëve që panë yllin dhe u mbushën me një gëzim të madh ekziston akoma edhe sot dhe kjo është një lloj shenje që Krishti ishte Perëndia dhe Perëndia është i pavdekshëm e ruan gjithmonë freskinë. Ajo skenë që ka ndodhur para 2000 vjetësh (vijon në faqen 4)*

Gjirokastrë

Në të gjitha kishat e kësaj dioqeze, festa u përjetua me entuziazëm, jo vetëm nga bano-rët e qytetit, por edhe nga emigrantët e shumtë që kishin ardhur për festat e fundvitit.

Mitropoliti i Gjirokastrës, Hirësi Dhimitri, i ftoi besimtarët orthodhoksë gjirokastritë të merrnin pjesë në shërbesën e Liturgjisë Hyjnore që do të zhvillohej në kishën “Meta-morfoza e Shpëtimtarit”, më 25 Dhjetor, me qëllim që ata të ishin së bashku këtë të kremte. Që në orët e para të mëngjesit, besimtarët kishin ardhur për të marrë pjesë në shërbesat e ditës festive. Para besimtarëve orthodhoksë, pjesëmarrës në këtë Liturgji Hyjnore, u lexua mesazhi i Kryepiskopit Anastas, “Çudi!” me rastin e Krishtlindjeve.

Atmosfera e festës vijoi për disa ditë, me takime të shumta, urime dhe përshëndetje mes klerikëve e besimtarëve, të cilët këto ditë të bekuara i festuan së bashku sipas traditës së shenjtë orthodhokse. Gjithashtu, si çdo vit, Hirësi Dhimitri, priti personalitete të qytetit, si edhe besimtarë të shumtë në mjediset e Mitropolisë së Shenjtë.

Hirësi Joanit i dorëzohet titulli “Qytetar Nderi”

- Në datën 19 dhjetor 2008, Këshilli Bashkiak i qytetit i dorëzoi Hirësi Joanit titullin “Qytetar Nderi” i Bashkisë Korçë -

Dhënia e këtij titulli është një vlerësim që i bëhet jo vetëm Hirësisë së Tij personalisht, por të gjithë komunitetit dhe vetë Kishës Orthodhokse. Të dish të vlerësosh, do të thotë të dish të jesh mirënjohës jo vetëm kundrejt disa njerëzve. Kjo do të thotë që të dish të jesh mirënjohës dhe falënderues për njerëzit që Zoti dërgon pranë nesh. Dhe ne të gjithë i jemi mirënjohës Zotit, që në krye të Kishës sonë ka dërguar njerëz si Kryepiskopi Anastas, por edhe që i ka dhënë grigjës dhe Mitropolisë sonë një Kryebari të tillë si Imzot Joani.

Këto ishin disa nga ato që u thanë në këtë ditë, duke përmendur kontributin e veçantë të Hirësi Joanit dhe të asaj çka ai përfaqëson dhe bën në qytetin tonë. Fjalën e rastit e mbajti Stavrofor atë Ilia Kotnani, i cili u përqendrua në aspektet e jetës dhe shërbimit kishtar të Hirësi Joanit. Në emër të intelektualëve korçarë përshëndeti znj. Jonela Spaho, pedagoge në Universitetin “Fan Noli” të Korçës, dhe në emër të rinisë përshëndeti Mihal Sonellari. Gjithashtu, pati përshtypje dhe vlerësime edhe nga të pranishmit në sallë.

Në emër të Kryepiskopit Anastas përshëndeti Hirësi Andoni.



Korçë

(vijon nga faqja 3)

ka frymëzuar për 2000 vjet dhe do të frymëzojë në jetë të jetëve të gjithë njerëzit. Shumë gjëra kanë ardhur dhe kanë ikur, gjithsekush që di historinë e njerëzimit e di se sa shumë gjëra fituan famë për një periudhë të shkurtër dhe prapë janë zhdukur, ndërsa ngjarja që ka ndodhur para 2000 vjetësh në Betlehem vazhdon akoma edhe sot ta ruajë freskinë, vazhdon akoma edhe sot ta ruajë gëzimin.

Askush nuk do të gëzohet, nëse shpirti i Tij do të jetë në errësirë, prandaj unë do t'ju kërkoja të gjithëve ju, motra e vëllezër të dashur më Krishtin, që kjo ditë të shërbejë për një pajtim akoma më të madh. Le të shërbejë kjo ditë për të falur çdo të keqe që kemi ne dhe për ta ndriçuar shpirtin me dritën e Krishtit. Drita ka ardhur në botë dhe i përket gjithsecilit nga ne që ta ndezë pishtarin e Tij të drita e madhe dhe lum ai njeri që do të futë në zemrën dhe shpirtin e tij dritën e Krishtit. Ai do të fitojë arin, do të fitojë temjanin do të fitojë edhe pavdekësinë."

Mbas Liturgjisë së Krishtlindjes, në selinë e Mitropolisë së Shënjtë, Imzot Joani priti vizita dhe urime nga pushtetarë vendorë dhe personalitete të tjera të qytetit, si edhe nga qindra besimtarë që në këtë ditë shkëmbenin urime njëri me tjetrin duke reflektuar gëzimin e natyrshëm të kësaj dite.

Në datën 26 dhjetor, në mensën "Shërbesa e Dashurisë", Imzot Joani shtroi një drekë dhe festoi së bashku me njerëz në nevojë dhe të braktisur. Ajo u shtrua për rreth 120 persona dhe pati si mesazh jo vetëm mbështetjen për ta, por për një ndihmesë me dinjitet.

Mihal Sonellari

Shfaqje festive me rastin e Krishtlindjeve e Akademisë Teologjike, Liceut Kishtar dhe "Shtëpisë Orthodhokse të Shpresës" në Manastirin e Shën Vlashit

"Krishti lindi, lavdërojeni!" Me këtë thirrje të gëzueshme në atmosferën mbushur me drita e dekor simbolik, u mbush Manastiri i Shën Vlashit pasditen e 18 dhjetorit. Studentët e Akademisë Teologjike "Ngjallja e Krishtit", nxënësit e Shkollës së Mesme Kishtarë "Kryqi i Nderuar", Sukth dhe fëmijët e "Shtëpisë

Orthodhokse të Shpresës" e kremtuan ardhjen e Krishtlindjes përmes një programi festiv që zgjati rreth dy orë, i mbushur me këngë, dramatizime, pjesë humoristike dhe me mesazhet e vërteta të Krishtlindjes.

Gjatë programit foli edhe zëvendësudrejtori i Akademisë, Episkopi i Apollonisë, Hirësi Nikolla.



Shën Vasili në Gjirokastrë

Atmosferë festive përcolli edhe festa e Shën Vasilit të Madh, më 1 janar, në kishën e Kryeengjëjve, drejtuar nga Hirësi Dhimitri, ku merrnin pjesë klerikë dhe besimtarë të shumtë të qytetit të Gjirokastrës.

Në fund të Liturgjisë, Mitropoliti i ftoi besimtarët të merrnin pjesë në qendrën shpirtërore që ndodhet pranë kishës për ndarjen e kekut të Shën Vasilit. Pas këtij aktiviteti, i cili krijon një atmosferë shumë të gëzueshme, Mitropoliti Dhimitër së bashku me të rinj dhe të reja orthodho-

kse të qytetit shkuan në azilin e qytetit, për të shpërndarë dhurata për të moshuarit si edhe mesazhet e urimit. Ata u mirëpritën me shumë ngrohtësi dhe dashuri, duke kaluar kështu së bashku çaste festive dhe gëzimi.

Vlen të theksohet se me iniciativën e rinisë orthodhokse, gjatë ditëve festive të Krishtlindjes, u shpërndanë ndihma dhe dhurata edhe për familjet e dëmtuara të pallatit që u shkatërrua para pak kohësh në një nga lagjet kryesore të qytetit të Gjirokastrës.



Organ i Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë

Themelues:
Kryepiskopi Anastas

Del nën kujdesin
e Këshillit Botues

Kryeredaktor: Thoma Dhima

Adresa:

Kryepiskopata Orthodhokse,
Rruga e Kavajës, Nr. 151
Tiranë

Tel: (04) 2234 117, (04) 2235 095

Fax: (04) 2232 109

Shtypur

në shtypshkronjën "Ngjallja"

Shfaqje për Krishtlindje e nxënësve të shkollës "Protagonistët"



Më 19 dhjetor, salla e Muzeut Historik ishte mbushur plot me prindër, fëmijë dhe të ftuar, të cilët ndoqën shfaqjen festive të 160 nxënësve të shkollës 9-vjeçare "Protagonistët". I pranishëm ishte edhe Kryepiskopi Anastas.

Programi nisi me përcejlljen e mesazheve nga ana e fëmijëve, që sillnin lajmin se po afrojnë Krishtlindjet dhe të gjithë duhet të bëhen gati. Në vazhdim, nxënësit kënduan këngë, recituan poezi, luajtën në piano, duke treguar se çfarë kishin mësuar gjatë gjithë vitit në shqip, anglisht dhe greqisht, duke shprehur njëkohësisht edhe talentet e tyre në fusha të ndryshme.

Kremtim festiv i Ujit të Bekuar në të gjithë vendin

Tiranë, Kryepiskopi Anastas bën Bekimin e Ujërave

Kremtimet e shumta në periudhën midis dy viteve u finalizuan me festën e Theofanisë, më 6 janar. Brenda dhe jashtë saj kisha "Ungjillëzimi i Hyjlindësës" ishte mbushur me qindra besimtarë.

Fortlumburia e Tij, Kryepiskopi Anastas, drejtoi Liturgjinë Hyjnore dhe shërbesën e Bekimit të Madh të Ujit, i shoqëruar nga kleri dhe 2 koret e Kishës. Ai iu drejtua besimtarëve se, dita e Pagëzimit të Zotit tonë Jisu Krisht shënon edhe fillimin e misionit të Tij shpëtimtar.

Kryepiskopi theksoi se dita e shfaqjes së Perëndisë Triadik prej së larti përbën edhe hapjen e rrugës për të gjithë drejt shpëtimit. Në pagëzimin e Tij, Krishti fillon të predikojë ardhjen



e Mbretërisë së Perëndisë. Krishti nuk kishte nevojë të pagëzohej, por na tregoi edhe ne se duhet të ecim në rrugën që Ai vetë e filloi.

Pas Shërbesës së Bekimit të Ujit, mijëra e

mijëra besimtarë morën për gjatë gjithë ditës Ujin e Bekuar, të ndihmuar edhe nga pikat e shumta të instaluar për shpërndarjen e tij.

I.K.

Berat



Me pagëzimin e Tij Krishti shenjtëroi natyrën e ujërave dhe varrosi në lumin e Jordanit mëkatet tona. Kjo ngjarje u përjetua përsëri në qytetin e bukur të Beratit me Shërbesat e Shenjta të cilat u kryen në datat 5 dhe 6 janar.

Më datën 6 u kryen nga Hirësi Ignati shërbesat e Liturgjisë së Joan Gojartit, e Bekimit të Madh të Ujit, si edhe ajo e hedhjes së kryqit nga Ura e Goricës mbi lumin Osum.

Me qindra besimtarë morën pjesë në këto ditë të shenjta. Ata ndanë midis tyre ujin e mbushur me Hirin e Shpirtit të Shenjtë, i cili do të qëndrojë në shtëpitë e shpresëtarëve për një vit të tërë. Me dhjetëra djem sfiduan ujërat e ftohta të Osumit për të marrë pjesë në bekimin e Kryqit të Shenjtë.

J. Q.

Vlorë

Dhjetëra besimtarë orthodhoksë vlonjatë morën pjesë në shërbesat në kishën e Shën Theodhorit dhe në ceremoninë e hedhjes së kryqit në det.

Pas meshës, që u krye nga atë Konstandin Prifti, në bregun e Plazhit të Ri u organizua ceremonia e hedhjes së kryqit në det. Kryqin e gjeti 50-vjeçari Vangjel Ndini.

Fier

Mijëra besimtarë orthodhoksë mbushën kishën e Shën Gjergjit, në qytetin e Fierit, qysh në orët e para të mëngjesit, për të kremtuar Theofaninë, Ujin e Bekuar. Pas meshës që mbajti atë Ilia Bitri, u krye riti i hedhjes së kryqit në ujin e shatërvanit në qendër të qytetit, afër kishës, ku kryqin e kapi një 14-vjeçar.

Korçë

Banorë të qytetit të Korçës kremtuan ditën e Ujit të Bekuar me Liturgjinë Hyjnore dhe shërbesat në katedralen "Ngjallja e Krishtit". Pastaj qindra e qindra besimtarë e qytetarë të Korçës morën pjesë në hedhjen e kryqit në ujë, që ashtu si çdo vit kryhet në shatërvanin, në sheshin para katedrales. Kryqin e hedhur nga Imzot Joani, e kapi për të dytin vit 27-vjeçari Olger Tona.

Uji i Bekuar dhe hedhja e kryqit në ujë, në rajonin e Korçës festohet në mënyrë të veçantë edhe në shumë fshatra, si në Polenë, Voskopojë e Vithkuq etj.

Pogradec

Të ftohtët nuk i pengoi mijëra banorë të Pogradecit të dalin sipas traditës së lashtë, për të kremtuar Ujin e Bekuar në breg të liqenit. Shërbesën e ndoqën edhe shumë të tjerë që kishin hipur në varka.

Mes të rinjve që u krodhën në liqen, kryqin e kapi Kristi Nikolla, një 18-vjeçar nga Pogradeci.

Durrës

Një 40-vjeçar nga Durrësi ka arritur të kapë kryqin në ujërat e ftohta të Adriatikut në të kremten e Theofanisë. Nikolla Zeneli, i cili u hodh në ujë së bashku me pesë të rinj të moshave nga 17-20 vjeç, ka pasur fatin të prekë i pari kryqin mes urimeve të qindra besimtarëve orthodhoksë që morën pjesë në ceremoninë e organizuar në kalatën 4 të Portit Detar të Durrësit.

Më parë, në kishën e Apostull Pavlit dhe Shën Astit, u celebrua Liturgjia Hyjnore nga Hirësi Nikolla, Episkop i Apollonisë, i cili u shpreh se shfaqja e Jisuit si Mesia njerëzor dhe si Biri hyjnor i Perëndisë përbën theksin e kësaj feste.

Përmet

Atmosferë festive kishte Përmeti në ditën e Theofanisë. Është një traditë e bukur në këtë qytet të vogël ku banorët, jo vetëm ata të besimit Orthodhoks, dalin në brigjet e Vjosës, në afërsi

të urës, për të ndjekur shërbesën aq festive të hedhjes së kryqit në ujëra.

Liturgjinë Hyjnore në kishën e bukur të Shenjtores Parashqevi e kreu Mitropoliti i Gjirokastrës, Hirësia e Tij Dhimitri.

Pas mbarimit të shërbesës në lumin e Vjosës (kryqin e mori nga ujërat i riu përmetar Ridi Mustafaj), në mjediset e kopshtit të fëmijëve në kishën "Lindja e së Tërshenjtës Mari", Mitropoliti preu sipas traditës vasilopitën e enorisë.



Gjirokastrë

Pas Liturgjisë Hyjnore në kishën e Kryeengjëjve, u vazhdua me shërbesën e hedhjes së kryqit në ujërat e lumit Drino, pranë vendit të quajtur "Ura e lumit". Shërbesat u kryen nga atë Theodhori Nikolla. Veç dhjetëra besimtarëve të qytetit, ritet u ndoqën dhe nga shumë emigrantë të ardhur për festat.

Elbasan

Me qindra besimtarë orthodhoksë të Elbasanit kanë marrë pjesë në ceremoninë e hedhjes së kryqit në ujë, në ditën e Theofanisë. Kryqi është kapur për të tretin vit radhazi nga Julian Luli, 28 vjeç.

Shërbesa u krye pas Liturgjisë në kishën e Shën Thanasit nga Episkopi i Krujës, Hirësi Andoni dhe atë Stavri Çipi. Pastaj të gjithë u drejtuan tek një kompleks pishinash i qytetit të Elbasanit, ku u krye shërbesa e hedhjes së kryqit në ujë.



Në fotot (nga lart poshtë):

21 dhjetor

Efqelia e Shenjtë në kishën “Ungjillëzimi i Hyjlindës”, Tiranë.

24 dhjetor

Kolendrat në familjet orthodhokse

25 dhjetor

Çast nga mesha e Krishtlindjes.



Kremtimi i Krishtlindjes në Tiranë

Atmosfera festive e Krishtlindjes nisi të ndihej që më parë, me përgatitjet për ta pritur sa më mirë Krishtin-Foshnjë, pas një periudhe të gjatë kreshmimi dhe lutjeje, si edhe me veprimtaritë e të rinjve dhe fëmijëve etj.

Kremtimi i parë ishte ai i së Die-lës para Krishtlindjes, pasditen e së cilës besimtarët të mbledhur në kishën “Ungjillëzimi i Perëndilindës Mari”, morën pjesë në Misterin e Efqelisë, atë të lyerjes me vaj të shenjtëruar. Një traditë kjo tashmë e konsoliduar në pritje të kësaj të kremteje të madhe.

Të hënën, 24 dhjetor, herët në mëngjes besimtarët morën pjesë në Shërbesën e bukur të Orëve të

Mëdha të Krishtlindjes, të mbushur me tropare dhe me lexime nga Dhiata e Vjetër dhe e Re, që flasin për Lindjen e Krishtit, duke u pasuar më pas me Shërbesën e Mbrëmësorës dhe atë të Liturgjisë Hyjnore të Vasilit të Madh.

E veçanta e kësaj dite ishte një grup i madh fëmijësh dhe të rinjsh, të cilët këndonin kolendrat tradicionale, duke shkuar nëpër shtëpitë e besimtarëve. Ata shkuan edhe në Kryepiskopatën e Hirshme dhe gëzuan e bashkëbiseduan me Kryepiskopin Anastas.

Të gjitha veprimtaritë dhe përgatitjet shpirtërore të besimtarëve orthodhoksë kulmuan, në datën 25 Dhjetor, me shërbesat festive dhe Liturgjinë Hyjnore të Krishtlindjes, të cilat u kryen nga Fortlumturia e Tij Anastasi, i cili lexoi Mesazhin e përvitshëm, që këtë vit kishte si titull “Çudi!”, duke iu referuar çudisë së mistershme të Lindjes së Zotit.

Gëzimi dhe atmosfera festive vazhduan në kishë tërë ditën, me ardhjen e mijëra besimtarëve dhe banorëve të kryeqytetit.

Korresp. i gazetës “Ngjallja”

(vijon nga faqja 1)

tolerancë, më shumë harmoni. Religjionet kanë qenë gjithmonë pikë referimi dhe protagonistë të qetësimit të ujërave dhe në situatat më të vështira që ka pasur Shqipëria dhe kanë qenë misionare të forcimit të demokracisë në Shqipëri, kështu që kemi çka të mësojmë dhe kjo është një ditë e veçantë për ta dhënë këtë mesazh. Ju uroj edhe një herë të gjithëve gëzuar!”

Për të uruar erdhi edhe Kryeministri, z. Sali Berisha me bashkëshorten, i cili pati një bashkëbisedim të ngrohtë me Kryepiskopin Anastas, ku vlerësoi si gjithnjë punën e bërë deri më tani.

Në fund Kryeministri deklaroi se: “Është ditë e madhe në të cilën unë dua t’ju përcjell urimet më vëllazërore, më të përzemërta të gjithë besimtarëve të krishterë në këtë ditë të Lindjes së Krishtit, të

Tiranë - Pritje me rastin e Krishtlindjeve në Kryepiskopatën e Shenjtë

lindjes së përjetësisë, shpresës, forcës së pashtershme shpirtërore të njeriut, por dhe të gjithë besimtarëve shqiptarë që kanë në besimin të Zoti motivin më të madh të përpjekjeve, të sakrificave të tyre për veten, familjen, vendin dhe shoqërinë në tërësi”, u shpreh Kryeministri Berisha.

...“Pra edhe njëherë le të falë-

nderojmë Zotin në këtë ditë të madhe për të gjitha këto mirësi që kombi pati gjatë këtij viti dhe le të urojmë dhe shpresojmë që viti tjetër të na gjejë edhe më mirë”, vijoi më tej Kryeministri Berisha.

Për të uruar Komunitetin Orthodhoks erdhi në Kryepiskopatë edhe Kryetari i Partisë Socialiste dhe i Bashkisë së Tiranës, z. Edi

Rama, i cili do të deklaronte se:

“Dua t’ju uroj shërim të shpejtë të gjithë atyre që janë të pamundur. Dua t’ju uroj shpresë dhe mundësi të gjithë atyre, që janë të varfër e të papunë, në një Shqipëri që jeton ditë të vështira dhe ku kemi nevojë të gjithë për një besim të ri, në mënyrë që të bëjmë realitet ëndrrat e fëmijëve, ambiciet e të rinjve, dëshirat e prindërve, lutjet e të moshuarve. Gëzuar të gjithëve dhe sa më shumë fat.”



ÇUDI!

(vijon nga faqja 1)

Ngjarja tronditëse që ndryshoi rrjedhën e historisë së botës zhvillohet pa zhurmë, larg nga qendrat e vendimeve politike dhe ushtarake të Perandorisë Romake, që besonin se rregullonin fatin e planetit; larg rretheve ekonomike dhe tregtare, larg nga qarqet filozofike dhe fetare të botës së atëhershme, që mendonin se njihnin ligjet e natyrës apo ligjet e Perëndisë. “Se këshillat e mia nuk janë si këshillat tua, as

Ai që vjen për të udhëhequr gjininë njerëzore drejt shpëtimit “lindet në shpellë”, mohon çdo lloj forme të botës së jashtme, përbuz luksin, jeton nga çasti më i parë jetën e njerëzve të thjeshtë, të të përlururve dhe të varfërve, pra të shumicës dërrmuese të popullsisë së tokës.

rugët tua nuk janë si rugët e mia, thotë Zoti” (Isaia 55:8), ka theksuar profeti Isaia.

Të gjitha sa kanë lidhje me Jisu Krishtin, në pamje të parë përbëjnë një sfidë për logjikën e zakonshme. Shpesh e përmbysin, por përfundimisht e zgjerojnë horizontin e saj. Kanë një dinamikë të pashtershme, një energji krijuese. Sa njohën Krishtin, sa e besuan dhe u lidhën me anë të dashurisë me Atë, konstatojnë dhe përjetojnë se Perëndia Triadik, të Cilin e zbuloi Jisui, nuk është një fuqi e epërme jopersonale, statike, moskokëçarëse, por është Perëndia i gjallë i dashurisë, *Perëndia i të papriturave*. Pa zhurmë, Ai çel horizonte të reja, aty ku të gjitha duken të mbyllura dhe pa shpresë. Ndërhyn me mënyra të pashpresuara në rrugëtimin e njerëzimit, të komunitetit në të cilin bëjmë pjesë, si edhe në jetën tonë personale. I jep jetës sonë zgjidhje të papritura për probleme të pazgjidhshme. Shpresa që ofron kjo e vërtetë në sprova na fuqizon dhe na ripërtërin. Dashuria që ajo shpërndan, pra dalja nga egoja jonë për të takuar tjetrin, shoqërohet nga hareja dhe paqja e brendshme.

Jeta “më Krishtin” është e mbushur me eksperiencë të mrekullueshme. Bëhet fjalë për një transformim shpirtëror të vazhdueshëm.

* *

Përkundrazi, mënyrat si e festojmë Krishtlindjen, në kohën tonë përbëjnë një çudi të hidhur. Në vend të thjeshtësisë dhe të përlësisë, mbizotëron luksi, të dukurit, lakmia, dëshirimi dhe nxjerrja në pah e pasurisë materiale, prirja marramendëse për kënaqësi, nënvlerësimi dhe përbuzja e të mirave shpirtërore.

Madje në këtë epokë, planetin po e shqetëson një tjetër e papritur e pakëndshme: kolapsi i ekonomisë. Aktiviteti ekonomik i shtrembër, që adhuron fitimin dhe injoron e përbuz njeriun dhe zhvat krijesën, çoi në krizën e njohur ekonomike botërore, që si një uragan i tmerrshëm kërcënon pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Por kryesisht përfundon në një mundim të ri të miliona njerëzve të thjeshtë dhe të varfër.

Propozimet për daljen imediate nga kriza, janë të shumta dhe të lavdërueshme. Por në një periudhë afatgjatë, më në përgjithësi sprova që kalon njerëzimi kërkon ndryshime më rrënjësore. Fjala e përjetshme e Perëndisë, Mishërimin e të Cilit ne festojmë, tregon në mënyrë diakronike drejtimin: Thjeshtësi dhe vetëpërbajtje në jetën personale. Më shumë reciprocitet, më tepër dashuri autentike dhe respekt të vërtetë ndaj dinjitetit të çdo personi njerëzor, kudo dhe në çfarëdolloj kushtesh që ka lindur. Sepse merr pjesë në natyrën

Pa zhurmë, Ai çel horizonte të reja, aty ku të gjitha duken të mbyllura dhe pa shpresë. Ndërhyn me mënyra të pashpresuara në rrugëtimin e njerëzimit, të komunitetit në të cilin bëjmë pjesë, si edhe në jetën tonë personale. I jep jetës sonë zgjidhje të papritura për probleme të pazgjidhshme.

njerëzore, të cilën e mori dhe e lartësoi Biri i Perëndisë. Kjo formë jetese e rinovon jetën dhe e pasuron nga ana shpirtërore, duke i falur asaj bukuri unike. Dhe si përfundim, përforcon drejtësinë shoqërore dhe krijon qytetërimin e vërtetë.

Aktiviteti ekonomik i shtrembër, që adhuron fitimin dhe injoron e përbuz njeriun dhe zhvat krijesën, çoi në krizën e njohur ekonomike botërore, që si një uragan i tmerrshëm kërcënon pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Por kryesisht përfundon në një mundim të ri të miliona njerëzve të thjeshtë dhe të varfër.

* *

Le ta festojmë ardhjen e Çlirimtarit dhe le të tregojmë përkushtimin dhe besnikërinë tonë ndaj Atij, *duke rezistuar cilësisht* ndaj mentalitetit sundues të lakmisë, zemërgurtësisë dhe abuzimit me mjedisin. Këto e kanë çuar njerëzimin në idhujtarinë e re të parasë, të pasurimit të paligjshëm. Njeriu bashkëkohor, duke mos e vënë në qendër Fjalën e Perëndisë dhe duke përbuzur Perëndinë, përfundoi në nënneri. Sa vuajmë për lartësimin esencial të shoqërisë, ftohemi t’i rezistojmë këtij mentaliteti, ngado që të vijë, ndaj kujt do që edhe e ushqen.

Fjala e bërë njeri e Perëndisë së urtësisë dhe dashurisë, le të drejtojë përditë jetën tonë, duke e mbushur atë me optimizëm dhe hare, në këto ditë festive dhe gjatë gjithë vitit të ardhshëm.

Krishtlindje të bekuara!

Me të gjithë dashurinë time më Krishtin

† Anastasi

Dhjetor, 2008

DHURUESIT KORÇARË TË SHEK. TË XIX-TË

**Alma Gjermani
(Ballauri)**

...Korça rreth vitit 1850 mban sikeptrin, nga pikëpamja e pasurisë shoqërore midis komuniteteve të tjera të krishtera të Maqedonisë dhe Epirit. (A. Ismirliadhu, Korça-Arsimi-Dhuruesit-Ekonomia, f. 42). ...Ka një sistem të zhvilluar arsimor, një numër të madh institucionesh sociale, por vendin kryesor e zënë kishat. Në këtë kohë fillon të ndërtohet dhe kisha madhështore e Shën Gjergjit....

Një nga faktorët kryesorë që ndikuan në krijimin e këtyre tipareve të qytetit të Korçës ka qenë fenomeni i dhurimeve të mëdha, që bënë korçarët e komunitetit orthodhoks, në të mirë të këtij komuniteti, si nga ata që banonin në qytet dhe nga ata të diasporës jashtë saj...

Për të administruar sa më mirë dhuratat e bëra, me iniciativën e Mitropolitit Neofit, organizohet më 1850 krijimi i arkës shoqërore të qytetit, e ashtuquajtura "Llaso". Krijimi i "Llasos" shoqërohet dhe me përpilimin e një rregulloreje të rreptë, e cila do të garantonte administrimin efikas të shumave të grumbulluara në të. Pas vitit 1856, fenomeni i dhurimeve nga qytetarët e komunitetit orthodhoks të Korçës, komunitet i cili përbënte shumicën e popullsisë së qytetit, merr një hov të madh. Arsyeja është, se në këtë vit u shpall dekreti i Sulltanit, i ashtuquajtur Dekreti i Hati Humaiun, i cili u jepte një varg të drejtash komuniteteve jomyslimane të perandorisë. Në bazë të këtij dekreti, këto komunitete kanë të drejtë, këtej e tutje, të krijojnë institucionet e tyre administrative, të pavarura pjesërisht nga administrata osmane. Detyra e këtyre institucioneve ishte të zgjidhnin një pjesë të problemeve të brendshme të komunitetit të tyre. Duke shfrytëzuar këto të drejta, komuniteti orthodhoks i Korçës, më 5 nëntor 1875, në një mbledhje të zgjeruar të anëtarëve të saj, zgjedh një këshill të përbërë prej dhjetë anëtarësh. Ky këshill do të quhet "Pleqësia" e qytetit (Dhimogjerondia). Ai përpilon të ashtuquajturën "Rregullore e përgjithshme e



institucioneve të përbashkëta të qytetit të Korçës".

Kryetari i këshillit ishte Mitropolit i Korçës, kurse anëtarët e zgjedhur ishin persona që gëzonin respektin dhe besimin e qytetarëve. ...Rëndësi të veçantë i jepet mbajtjes së rregullt të librave të llogarisë për shpenzimet e kryera. Në to shpjegohet me hollësi se ku kanë shkuar dhuratat e bëra. Shumën më të madhe e kapin shpenzimet për mbajtjen e shkollave, pastaj janë shpenzimet për administrimin e kishave, shpenzimet për pajat e vajzave të familjeve të varfra, për mirëmbajtjen e rrugëve, kanalizimeve, për jetimoren, për farmacinë e të varfërve, etj.

Me organizimin e "Llasos" dhe përpilimin e "Rregullores së Përgjithshme" krijohet një klimë inkurajuese, për të kontribuar në të mirë të komunitetit nga ana e anëtarëve të saj. Pas këtij momenti dhuratat që bëjnë korçarët në të mirë të qytetit janë më të mëdha dhe më të shpeshta. Emrat e dhuruesve shkruhen në kodikun e "Llasos" dhe lexohen çdo vit ditën e festës fetare të "Tre Hierarkëve" (Tre Arkondët), më 30 janar. Lista e dhuruesve është e gjatë dhe e shumëllojshme. Aty

janë regjistruar emrat e të gjithëve pavarësisht nga kontributi dhe të gjithë janë përmendur me respektin më të madh përpara qytetarëve në ditën e "Tre Hierarkëve" në Kishë. Vlejnë për t'u përmendur në mënyrë të veçantë dhuratat e Dhimitër Cickës prej 8.000 lira angleze, e Vangjel Kristos prej 3.000 lira, e Kostandin Filipit prej 1.600 lira, e Jorgo Noskut prej 5.000 lira franceze, e Kostaq Duros prej 1.000 lira angleze, e Naum K. Dine prej 900 lira. Mjaft e madhe është dhurata e vëllezërve Adham e cila kap shifrën prej 12.000 lirash egjiptiane. Vëllezërit Thoma Adham dhe Jorgo Adham, kishin emigruar në Egjipt, ku kishin krijuar pasuri të konsiderueshme. Me dhuratën e tyre ndërtohet përsëri ndërtesa e bukur e Mitropolisë, mbasi ekzistuesja u dogj në gusht të 1894. Po nga kjo dhuratë ndërtohet dhe shkolla e vajzave ngjitur me të. Mbi portën

e ndërtesës së Mitropolisë, është shkruar mbi një pllakë mermeri, në greqisht, si më poshtë: "Në vitin 1896 në kohën e Gjervasi Mitropolitit rindërtohet Mitropolia e Shenjtë me shpenzimet shumë të mëdha të mirëbërësve bujarë A. Adham, Thoma, Dhionis dhe Jorgji, e cila u dogj nga dora e panjohur, në Korçë më 12 korrik". Nga fondi i dhuratës së tyre u shpenzua dhe për institucione të tjera sociale të qytetit.

Në listën e gjatë të dhuruesve të shek. të XIX-të, vendin kryesor zënë Jovan Banga dhe Anastas Adham-Lakshe.

Jovan Banga ka lindur në Korçë më 1814 dhe ka vdekur më 1895... Puna në Rumani i sjell fitime shumë të mëdha... Ëndrra e tij është të ndihmojë sa më shumë ekonomikisht qytetin e tij të lindjes. Vazhdimisht dërgon në Korçë shuma të mëdha për të ndërtuar shkolla për djem e për vajza, për ndërtimin e kishave dhe veçanërisht të Mitropolisë, për ujësjellësin e qytetit etj.... "Pasuria e Jovan Bangës në vitin 1895 arrinte shifrën prej 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) dhrahmi, shumë e cila për kohën konsiderohej shumë e madhe. Në vitin 1889 pasurinë e tij, Jovan Banga ia dorëzon për administrim qeverisë greke me anën e një prokure, në të cilën përshkruhet me hollësi mënyra e investimit dhe e shfrytëzimit të saj. Vendin kryesor në shpenzimet e zë organizimi dhe mirëmbajtja e Gjimnazit të Korçës, i cili do të organizohej në bazë të programeve më të përparuara të Evropës. Një pjesë e pasurisë do të disponohej për arsimin e fëmijëve korçarë, të cilët do të vazhdonin studimet në Universitetin e Athinës, ose në institucione të tjera. Gjithashtu ishte parashikuar një fond për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e jetimores në Athinë dhe e jetimores në Korçë....

(vijon në numrin e ardhshëm)

Marrë nga revista "Tempulli" nr. 13.

Për më tepër informacion rreth

KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË

vizitoni faqen tonë të internetit

www.orthodoxalbania.org

ose na kontaktoni në

orthchal@orthodoxalbania.org

Sfidat e mijëvjeçarit të tretë

**Oliver Clement,
teolog**

Fillimi i mijëvjeçarit të tretë është shënuar në vazhdimësinë e ndarjes së vërtetë historike që paraqesin ngjarjet e vitit 1989, konkretisht me rënien e murit të Berlinit. Shekullin e 20^{të} e karakterizuan shumë ideologji si komunizmi, ateizmi racionalist, që kishte si ambicie të fabrikonte një njeri të ri. Ky boshllëk, pasojë e ideologjive gjithashtu nihiliste u mbush pjesërisht nga ajo që sot quhet shekullarizim.

Të krishterët, si një pakicë duhet të rrënjosen në shpirtëroret, përtej historisë, dhe në të njëjtën kohë të dëshmojnë një spiritualitet profetik dhe krijues, i aftë të hedhë dritë në histori. Kemi shansin të përfitojmë nga ajo që na sjell një shekull ku krishterimi është thelluar si asnjëherë më parë. Imazhi që kemi për Perëndinë ka ndryshuar ndjeshëm. Perëndia i gjykimit, i dënimit i ka lënë vendin një Perëndie që është plotësisht dashuri dhe paqe, i kryqëzuar me vullnetin e tij mbi të keqen e botës dhe që ndërkohë, nuk pushon së na dhëni fuqinë e ngjalljes e të jetës. Për shumë kohë theksi ishte vënë mbi hyjnoren, gjë që shtypte njerëzoren dhe lirinë. Më pas, njerëzorja kërcënoi të shtypte hyjnoren.

Po shkojmë drejt takimit të hyjnës me njerëzoren. I vetmi humanizëm me vlerë është humanizmi hyjnor. Kjo do të thotë se në krye të njeriut është Perëndia dhe në krye të Perëndisë, nëse guxoj ta them, është njeriu. Në këtë njerëzim hyjnor gjendet një nga çelësat e mijëvjeçarit të tretë. Në këtë kërkim të dyfishtë të identitetit dhe të



Teologu i mirënjohur Oliver Clement (i tretë djathtas) duke folur në Vëllazërinë Orthodhokse të Francës.

alteritetit (të qenit një tjetër), përgjigjen e gjejmë te misteri i Trinisë. Si ta kuptojmë këtë mendim? Shumë thjesht: Ëndërrojnë për unitet dhe goditen mbi kokë nga diversiteti i tyre. Nuk e kanë kuptuar ende se uniteti kërkon me ngulm diversitet. Edhe demokracia e vërtetë, është të heqësh dorë nga vrasja e tjetrit.

Të krishterët duhet të respektojnë besimin dhe mungesën e tij. Nuk mund të përpiqemi të kuptojmë njeriun nëse evitojmë fetaren dhe antifetaren. Përfundimisht, ashtu

siç e thoshte edhe historiani Alfons Dypron, e gjithë historia është një histori e fesë ose e refuzimit të saj. Fjalën fe nuk duhet ta kuptojmë si fe dominuese mbi këtë apo atë territor, por si një hapje ndaj misterit. Duhet t'u jepet përgjigje pyetjeve të njeriut sot, i cili është jetim. Nuk ka rrënjë jashtë hapësirës dhe kohës. Njeriu ndihet i humbur në

kuptim. Por ideja e kthimit të Perëndisë mund të na lejojë të angazhohemi në një bisedim me bashkëkohësit tanë. Ky është një shans që duhet kapur, për ta mbushur me spiritualitet fetaren, dhe të përpiqemi të ngremë dialogun mes feve dhe kulturave, dhe jo për t'u fshehur në një spiritualitet pa përmbajtje.

Të krishterët janë thirrur të thellojnë atë që u është dhënë dhe atë që është Zbulim, më tepër se të tundohen nga "një çorbë pa krijues", që do të ushqente gjithë llojet e abuzimeve dhe gënjeshtreve.

Për këtë mijëvjeçar të tretë besoj shumë për një takim të ngrohtë dhe produktiv mes Lindjes dhe Perëndimit. Kjo në një kuptim më të gjerë dhe jo mes katolikëve dhe orthodhoksëve. Flas për një takim mes botës shpirtërore dhe Azisë. Dhe kjo, pa rrezikuar themelet e vetë krishterimit, ky takim ka shanse të ushqejë një thellim të jashtëzakonshëm. Për shembull, sot, India dhe budistët janë të sensibilizuar nga krishterimi. Budizmi e shikon njeriun si një agregat i përhershëm, sot disa budistë nuk hezitojnë të flasin për personin, në kuptimin e zbulimit biblik dhe të krishterë. Spiritualiteti i mijëvjeçarit të tretë do të jetë më tepër transfigurues se refuzues, një spiritualitet paskal, i ngjalljes.

Veprimtari të Lidhjes së Grave Orthodhokse "Përhapja e Dashurisë"

Një tjetër përmasë e veprimtarive vullnetare të grave kanë qenë edhe pritjet e veçanta çdo të martë dhe të enjte me nevojtarët, duke përgatitur dhe shpërndarë pako me ushqime e veshmbathje tek 400 persona të varfër, jetimë, të sëmurë, të braktisur, invalidë etj.

Në këtë periudhë festash, gratë orthodhokse, të shoqëruara edhe nga klerikët, vizituan rreth 100 gra të moshuara dhe pleq të vetmuar në dy qendrat e shërbimit misionar të motrave të Nënë Terezës, ku u shpërndanë ëmbëlsira, detergjentë, veshmbathje etj.

Vizita urimi u kryen ditën e martë, dt. 30 dhjetor edhe në dy burgje të Tiranës, në burgun nr. 325 dhe në burgun nr. 313, ku u shpërndanë 690 pako me ëmbëlsira e veshmbathje për të gjithë personat që vuajnë dënimin e tyre në këto burgje. Fondi për blerjen dhe përgatitjen e këtyre pakove u mundësua nga Bashkësia Ndërkombëtare e Burgjeve (PFI), me qendër në Zvicër.

Gjithashtu u organizuan edhe vizita në shtëpitë e besimtarëve të sëmurë, kryesisht të moshuar, ku edhe janë dhuruar ndihma të ndryshme.

Gratë përcollën kudo urimet e përzemërta të Kryepiskopit Anastas, i cili mundësoi pjesën më të madhe të fondeve shpenzuar për këto dhurata.

Gjatë kësaj periudhe, një ndihmë të rëndësishme dha edhe komuniteti i besimtarëve në arkat e ndihmës për të varfrit, në të dy kishat e Tiranës.

Rajmonda Shqevi





Apostull Timotheu (22 janar)

E njohim nga Veprat e Apostujve dhe Letrat e Pavlit (29 qershor). Lindi në Listra Likaonias, në brendësi, në jug të Azisë së Vogël. I ati ishte idhujtar, ndërsa e ëma, Evniki, e krishterë, e cila bashkë me gjyshen e tij Loidha e mëkuan që foshnjë me Shkrimet e Shenjta.

U tërhoq fuqishëm prej Pavlit dhe prej pësimeve të tij për hir të Krishtit, ndoshta në udhëtimin e tij të parë apostolik (vitet 47-48). Kështu, që nga udhëtimi i dytë (49-52) u bë bashkëpunëtor i pandashëm i tij në vend të apostull Markut (25 prill) për shumë vite (49-62), gjatë të cilave u formuan kishat më të rëndësishme. Pavli që në fillim e rrethpreu, që t'i lehtësojë veprimtarinë ndërmjet hebrenjve dhe i

ngarkonte misione mirëbesimi, si atë të Korinthianët.

Nxënësi i tij i dashur ndoshta e shoqëroi në Romë, por është e panjohur në shkuan bashkë në Spanjë. Korifeu e kishte përsëri pranë në udhëtimin e katërt (mbase 62-64). Atëherë e caktoi episkop - me gjithë karakterin e tij të ndrojtur - të Kishës së madhe të Efesit, në moshë rreth të 35-ve. Ndoshta Timotheu (greqisht = nderim Perëndie) u burgos për një periudhë. Shkoi në Romë i thirrur nga Pavli, ndërsa u kthye kur ai u martirizua (ndërmjet 64 dhe 68).

Sipas sinaksarëve, veproji si episkop mbasi internuan Joan Theologun (26 shtator) nga Efesi në Patmo dhe u martirizua (me sa

duket më 97), si vijon: Në festën e perëndisë së verës, Dionisit, idhujtarët e Efesit bënë procesion me idhuj, duke kënduar dhe duke goditur njëri - tjetrin me shkopin, të dehur siç duket, dhe duke vranë njëri-tjetrin. Episkopi u përpoq t'i këshillonte, por ata u inatosën dhe e vranë...

Lipsani u transferua më 356 në Konstandinopojë, prej nga e morën në shekullin e 13 - të. Së fundi u gjend në Termoli të Italisë.

Letrat e I-ë dhe e II-ë për Timotheun quhen baritore, si edhe ajo për Titon, sepse Pavli jep udhëzime për baritimin e besimtarëve. Përmajnë dogma kryesore rreth Kishës, Mistereve, Shkrimeve etj., dhe veçanërisht vendosin bazat e së Drejtës Kishtare.

Atë Justini

Tek ikonat që ekzistojnë brenda në Kishë janë të pikturuara pamjet e shenjtorëve, të atyre pjesëtarëve të Kishës që vulosën besimin me ushtrimin dhe gjakun e tyre. Me përpjekjet e tyre, kreshmët, agripnitë, lutjet, ose dhe me martirizimin, ata gjetën hir para Perëndisë dhe ndërmjetojnë për ne. Ata janë predikuesit e përgjithshëm të besimit të vërtetë orthodhoks dhe dëshmitarë okularë të fuqisë jetëdhënëse që tejkalon vdekjen me hirin e Zotit. Janë lavdia, bukuria dhe shtylla e Kishës që ruhet gjithmonë e pacenuar dhe e patundur me lutjet e tyre.

"M'u dha çdo pushtet në qiell e mbi dhë" (Mat. 28.18).

Këtë pushtet iu ka dhënë Zoti barinjve të Kishës, kryepërfitorinjtë, priftërinjtë dhe dhjakonëve, dhe kryen nëpërmjet tyre misteret e shenjta:

- Pagëzimin, me të cilin njerëzit rilinden "nëpërmjet ujit dhe frymës".

- Mirosjen, me anë të së cilës transmetohen dhuratat e Shpirtit të Shenjtë.

- Falënderimin Hyjnor, gjatë të cilit buka dhe vera shndërrohen në Trup dhe Gjak të Jisu Krishtit.

- Rrëfimin, me anë të të cilit falen mëkatet tona.

- Martesën, me anë të së cilës bekohet lidhja e burrit me gruan.

- Vajosjen e shenjtë, me anë të së cilës shërohen sëmundjet e shpirtit dhe të trupit.

Me këtë pushtet të gjithëfuqishëm ruajti Zoti Kishën e Tij që nga shekujt e parë të ekzistencës së saj, të atyre shekujve të frikshëm të përndjekjeve të pasueseve të Tij. Me këtë fuqi i ruajti të pamposhtur shenjtorët e Tij, me gjithë martirizimet që duruan dhe i lavdëroi në mënyrë të mrekullueshme. Me të njëjtat mjete ruan deri më sot besimtarët dhe do t'i ruajë deri në fund të botës nga armiqtë e dukshëm dhe të padukshëm.

Zoti zbriti nga qielli "që të shpëtojë të humburin" (Mat. 18.11) dhe themeloi mbi tokë Kishën e Tij. Brenda saj:

- shpëtohen të gjithë ata që dëshirojnë shpëtimin,

- shërohen të gjithë ata që dëshirojnë shëndetin shpirtëror dhe trupor,

- ndriçohen të gjithë ata që dëshirojnë të çlirohen nga errësira e mëkatit,

- forcohen të dobët,

- pastrohen të ndotur nga mëkati,

- çlirohen të gjithë besimtarët nga fatkeqësitë, vuajtjet dhe varfëria shpirtërore dhe pasurohen sipas Perëndisë me kungimin e mistereve të shenjta dhe me bashkimin me Zotin, i Cili mbulon lakuriqësinë dhe ndyrësinë tonë

dhe gjallëron shpirtat tanë.

Ja përse Kisha ka kaq vlerë të madhe për secilin prej nesh!

Por shumë njerëz, duke dashur tokën më tepër se qiellin, largohen nga Kisha, dhe jo vetëm kaq, por edhe e shajnë atë.

O vëllezërit e mi, të varfër e fatkeq!

Njihni fuqinë shpëtimtare të Kishës sonë të shenjtë dhe ejani përsëri pranë saj, si tek nëna e dhembshur që ka dashuri, që shpëton dhe ndërmjeton për ne te Perëndia. Duke parë dikush lumturinë tuaj sipërfaqësore nga jeta që bëni, mendon se jeni të shëndetshëm dhe me të vërtetë të kënaqur; që nuk keni nevojë për mjetet shëruese dhe shenjteruese të Kishës. Por kjo është vetëm pamja e jashtme, sepse në shpirt jeni të sëmurë dhe madje të vdekur.

Krishti është dashuri, prandaj dhe ne pjesëtarët e Kishës së Tij duhet të duam vëllezërit tanë, ashtu siç duam veten tonë. Të largojmë nga zemra jonë egoizmin dhe interesin për veten tonë; smirën dhe armiqtësinë, grindjet dhe zemërimin, kujtimin e së keqes dhe mërinë. Të falim të tjerët, ashtu siç dëshirojmë që edhe ata të na falin ne, t'i pranojmë të metat e tyre dhe t'i ndihmojmë me gjithë zemër dhe gatishmëri kur ata kanë nevojë.

Dashuria është treguesi kryesor i pjesëtarëve të Kishës së Krishtit: "Prej kësaj do t'ju njohin ju të gjithë se jeni nxënësit e Mi, në qoftë se keni dashuri për njëri-tjetrin" (Jn. 13.35).

Zot, mbill brenda nesh dashurinë Tënde, që të mos mendojmë dhe të mos kryejmë asnjëherë të keqen! Amin.

Përktheu: Rozeta Baba

Shkëputur nga libri "Qielli në tokë"

RADIO "NGJALLJA", NË FM 88.5 MHz.

Ajo transmeton për ju 24 orë program.

Do të dëgjoni gjithçka që ju duhet: programe shpirtërore, sociale dhe kulturore. Muzikë e zgjedhur kishtare, popullore dhe klasike, nga vendi dhe bota.

Ndiqui shërbesat kishtare në Radio "Ngjallja"!

Nga Mesazhi i Patriarkut Ekumenik Vartholomeu I për Krishtlindjet

Mes konfuzionit botëror dhe krizës së ditëve të sotme, këto të vërteta duken paradoksale. Shpresa e pjesës më të madhe të njerëzve, e mbështetur në “hyjnitë” e botës, u dëshmuar false çdo ditë dhe në mënyrë të përditshme dhe tragjike. Personi njerëzor është i poshtëruar dhe i shtypur mes numrave, makina-ve, kompjuterëve, spekulimeve në bursë, flamujve me ngjyra të ndryshme të një oportunizmi të kotë ideologjik. Natyra fyhet. Mjedisi vuan së bashku. Të rinjtë janë të zhgënjyer dhe revoltohen, protestojnë kundër padrejtësisë së të tashmes dhe paqartësisë për të ardhmen. “Terr, re dhe errësirë, një zë i madh” sundojnë botën tonë, duke dhënë përshtypjen se kërcënohet që të fshihet drita e shpresës që lind nga Betlehemi dhe që është fshehur himni engjëllor i gëzimit universal: “Lavdi Perëndisë në më të lartat, dhe paqe në Tokë njerëzve vullnetmirë”.

Megjithatë, Kisha na thërret të gjithëve në një reflektim të urtë dhe që të rivlerësojmë përparësitë e jetës, dhe që të kërkojmë në fytyrën e çdo “tjetri” imazhin e Perëndisë, të denjë për respekt, dhe me gjithë forcën që i vjen nga 2 mijë vjet përvojë Ajo nuk do pushojë së afirmuari që Fëmija i vendosur në grazhdin e Betlehemit është “shpresa e të gjithë kufijve të botës”, që Logos-i është arsyeja e jetës, që ai është shpengimi që Perëndia i dërgoi populli të Tij, pra gjithë njerëzimit.



Duke shpallur gjithë këtë dashuri, nga kjo seli martire e Kishës së Shenjtë dhe të Madhe të Konstandinopojës, gjithë bijve kudo në botë... çdo njeriu të etur për Perëndinë, invokojmë mbi të gjithë dashamirësinë, paqen e hirin dhe dhuratën shpëtuese të Atij që zbriti nga qiejt për ne dhe për shpëtimin tonë, dhe u mishërua nga Virgjëresha Mari, të Vetëmlindurit Bir të Perëndisë që u bë njeri. Atij i qoftë lavdia, fuqia, nderi dhe adhurimi, së bashku me Atin dhe Shpirtin e Shenjtë në shekuj.



◀ Bullgari, Theofania nuk është vetëm një ditë shërbesash, por edhe një festë e vërtetë tradicionale popullore.

▶ Rumani, ditën e Theofanisë spërkaten me Ujë të Bekuar jo vetëm njerëzit, por edhe shtëpitë, makinat, kafshët e punës etj.



Kalendari i Liturgjive Hyjnore, SHKURT 2009

1 E DIEL † 17 MATEUT.

Dësh. Trifoni. Dëshg. Perpetua etj.

2 E Hënë † Paraqitja e Zotit Krisht në Tempull (Ipapandia).

3 E Martë † Simeon Hyjpriti. Profeteshë Ana. Nikolla i Japonisë.

7 E Shtunë † Partheni i Lamp-sakës. Osh. Llukai në Stiri.

8 E DIEL † E TAGRAMBLEDH. E FAR. Dëshm. Theodor Stratilati. (Triodhi)

9 E Hënë Mbyllja e Ipapandisë. Dësh. Niqifori. Markeli i Sicilisë.

10 E Martë † Hierod. Harallambi. Osh. Zinon postieri. Ana suedezja.

11 E Mërkurë † Hierod. Vlasi dhe 7 dëshg. Mbr/sha Theodhora. (Hahet të gjithë.) † Osh. Afksenti, Maroni. Avramiu i Karës. Isaaku rus.

15 E DIEL † E PLANGPRISHËSIT. Ap. Onisimi nga 70⁺. Osh. Eusebi. 21 E Shtunë † E Shpirtrave. Osh. Timotheu. Efsthathi i Antiokisë.

22 E DIEL † TË LIDHURIT E MISHIT.

Dëshmorët në Evgjëni. 23 E Hënë Hierod. Polikarpi i Smirnës. Shën Gorgonia. Dëshg. Thea. (Hahet bulmet e peshk.)

24 E Martë † Gjetja I & II e kokës së Joan Pagëzorit. Osh. Erazmi në Kiev. (Hahet bulmet e peshk.)

25 E Mërkurë Tarasi i Kon/pojës. Hierod. Rigjini e 40 dësh. me të. (Hahet bulmet e peshk.)

26 E Enjte Dëshg. Fotinia samaritane, Anatolia etj. Porfiri i Gazës. (Hahet bulmet e peshk.)

27 E Premte Omol. Prokop dekapoliti. Dësh. Gjelas aktori. Osh. Asklipi. (Hahet bulmet e peshk.)

28 E Shtunë † Omol. Vasili. Oshg. Marana e Kira. (Omol. Kasiani) (Hahet bulmet e peshk.)

Ikona e Theofanisë - Pagëzimit të Krishtit

Ikona e Pagëzimit të Zotit është riprodhim i saktë i dëshmisë së Ungjillit (sipas Markut 1:9-11, Mattheut 3:13 -16, Llukait 3:21-22). Perëndia Triadik u shfaq, ndërsa Joani ishte duke pagëzuar Krishtin Shpirti i Shenjtë zbriti mbi kokën e Krishtit në formë pëllumbi, zëri i Atit dha dëshminë: “Ky është biri im i dashur që e kam pëlqyer”.

Në pjesën e sipërme të ikonës ekziston një pjesë e një rrethi që simbolizon hapjen e Qiejve: *Kjo pjesë e rrethit shënon praninë e Perëndisë që ndonjëherë në ikona shprehet akoma më tepër nga një bekim dore.*

Rrezet e dritës kanë zbritur mbi Krishtin me zbritjen e Shpirtit të Shenjtë në formën e një pëllumbi. Shpirti i Shenjtë është Perëndi, nuk është pëllumb, por u shfaq në formën e një pëllumbi dhe prandaj edhe u pikturua si pëllumb. Në ngjarje të tjera Shpirti i Shenjtë shfaqet si re ose si gjuhë flakësh. Gjithashtu Etërit e Shenjtë të Kishës shpjegojnë shfaqjen e Shpirtit të Shenjtë si një pëllumb në analogji me përmbytjen. Pëllumbi solli një degë ulliri në arkën e Noes duke lajmëruar përfundimin e përmbytjes dhe paqen e rikthyer mbi tokë. Tani Shpirti i Shenjtë zbrit në formën e një pëllumbi për të lajmëruar faljen e mëkateve dhe mëshirën e Perëndisë në botë.

Shpëtimtari Jisu është paraqitur pothuaj gjithnjë sikur ecën e bën lëvizje drejt Joanit.



Edhe Jisui, si u pagëzua, menjëherë doli nga uji. Edhe ja tek u hapën qiejt dhe pa Shpirtin e Perëndisë duke zbritur si pëllumb e duke ardhur mbi të. Edhe ja një zë nga qiejt që thoshte: Ky është biri im i dashur, që e kam pëlqyer.
Matth. 3:1-17

Mjeshtri erdhi te shërbëtori dhe i kërkoi ta pagëzonte. Me dorën e Tij të djathtë Ai bekon ujërat e Jordanit duke i shenjtëruar me anë të zhytjes së Tij. Që atëherë uji bëhet jo një imazh vdekjeje, por një lindje në jetën e re.

Shën Joan Pararendësi është shërbyes. Dora e tij e djathtë është vendosur mbi kokën e Shpëtimtarit. Ky veprim mistik ka qenë gjithnjë pjesë e ritualit të pagëzimit. Me dorën e tij të majtë bën një veprim lutjeje për të shprehur tronditjen që e mbërthen atë “Unë nuk guxoj të vë dorën mbi kokën tënde, shenjtëromë, o Zot”.

Në ikonë dy figurat e vogla zakonisht janë të paraqitura në këmbët e Shpëtimtarit, midis peshqve që notojnë në ujërat e Jordanit. Njëra prej tyre është ajo e një burri duke i kthyer kurrizin Krishtit. Tjetra është ajo e një gruaje, zakonisht duke u larguar. Këto detaje ilustronë tekstet e Dhiatës së Vjetër dhe janë një paraqytim i Pagëzimit të Krishtit: “Deti e pa dhe iku. Jordani mbrapsht u kthye” (Psalmi 114:3). Figura e mashkullit është një alegori e lumit Jordan. Figura femërore është një alegori e Detit të Kuq.

Engjëjt marrin pjesë në ritualin e shenjtë. Ata janë paraqitur me duart e tyre të mbuluara nga një mantel si një shenjë e respektit para Atij, të Cilit i shërbejnë.

THEOFANIA - Omeli mbi misterin e Trinisë së Shenjtë

“Sepse tre janë ata që dëshmojnë në qiell: Ati, Fjala dhe Shpirti i Shenjtë, dhe këta të tre janë një. Edhe tre janë ata që dëshmojnë mbi dhë: fryma, uji dhe gjaku, dhe këta të tre janë në një (bashkë)” (1 Joani 5:7-8).

Kur lexojmë Shkrimin e Shenjtë, duhet të jemi të kujdesshëm në kuptimin e çdo fjale. Kur bëjmë një lexim të nxituar, për shembull, syri nuk do ta kapë dallimin që Ungjillori bën mes trinisë qiellore dhe asaj tokësore. Në lidhje me Trininë qiellore ai thotë: “dhe këta janë një”; në lidhje me atë tokësore ai thotë: “dhe ata janë bashkë”. Ka një dallim të madh mes të qenit një dhe të qenit bashkë. Ati, Biri dhe Fryma e Shenjtë janë një, ndërsa fryma, uji dhe gjaku janë

vetëm bashkë, por nuk janë një. Edhe armiqët mund të jenë bashkë, por nuk janë një. Të gjithë njerëzit mbi tokë janë së bashku, por nuk janë një. Uji dhe gjaku ndërtojnë trupin, por fryma është frymë. “Se mishi i bën luftë frymës, dhe fryma mishit” (Gal. 5 : 17), kështu që nuk janë një, megjithëse janë bashkë. Kur një njeri vdes, kjo lidhje prishet, uji dhe gjaku shkojnë në një anë dhe fryma në anë tjetër. Megjithatë, Trinia e Shenjtë në qiell nuk është vetëm bashkë, por edhe Një.

Por ka një trini në qiellin e brendshëm të njeriut, që jo vetëm duhet të jetë e bashkuar, por dhe një unitet, që të bekohet në këtë jetë dhe në atë që do të vijë; është uniteti i frymës, i zemrës dhe i vullnetit. Kur këto tri pjesë kanë një lidhje të thjeshtë, njeriu është në luftë me këto tri pjesë të vetes së tij dhe me Trininë

qiellore. Kur këto pjesë fillojnë të bashkohen, të përbëjnë një unitet të vetëm, kur njëra nuk dominon dhe tjetra të ndihet e sunduar, në këtë çast njeriu mbushet me paqe që tejkalon çdo mendje (Fil.4 :7), çdo fjalë, çdo shprehje, frikë dhe dhimbje. Atëherë qielli i brendshëm i njeriut fillon të bëhet si qielli i madh i Perëndisë, e në këtë mënyrë ikona dhe ngjashmëria me Perëndinë fillojnë të qartësohen brenda nesh.

O Perëndi Trinisor, ndihmona t’u ngjasojmë atyre që Të ngjasojnë. Se Ty të përket lavdia dhe nderimi përjetë.

Amin.

**Përktheu Eleni Pani
Nga shën Nikolla Velimiroviç**